

AKTI I THEMELIMIT
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“SKY GLASS” sh.p.k

Në Tiranë, sot më datë 17/04/2023 (dymijë e njëzetë e tre), midis:

1- **Z. Sokol Parllaku** shtetas shqiptar, i biri i Fatmir, lindur me 28/07/1991 në Kukës, banues në Tiranë, nr. personal J10728064P madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Në vijim referuar së bashku si **“Ortakët”**.

Palët e sipërcituara përpilojnë këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojnë me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, me ligjin 9901 datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ligjin 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me atë të ligjit Doganor, Fiskal e Tatimor, dhe Autoritetit përkatës sipas objektit të shoqërisë, krijojnë Shoqërinë Tregtare të Kufizuar, **“SKY GLASS sh. p. k.**

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria “SKY GLASS” sh.p.k është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë referuar si **“Shoqëria”**).

Neni 2
Personaliteti Juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “SKY GLASS” sh.p.k është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ortakët të cilët secili në veçanti gëzojnë kuotat e tyre në shoqëri, në përpjestim me kontributin e dhënë në kapital. Kontributi i Ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortakët e shoqërisë mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, në rastin kur i kanë shlyer të gjitha kontributet e tyre.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Shqipëri, me adresë: DURRES Koxhas, km. 15, ne krah te Autostrades Durres-Tirane me nr pasurie 41/24 zona kadastrale 2255
Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e Ortakëve.

Neni 4 **Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria ka për objekt zhvillimin dhe pjesëmarrjen në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të zhvillojë sipas legjislacionit shqiptarë, por në mënyrë të veçantë: Shoqëria ka për objekt prodhim dhe furnizim vendosjen e dymë, dritare duralumini, plastike, punime xhamash, grila të të gjitha llojeve etj. Shoqëria mund të punësojë ose krijojë përfaqësi ose agjenci të ndërrarura prej saj me ose pa llogari(bankare) me vetë. Shoqëria në mënyrë të pa parashikuar dhe të rastësishme për të realizuar interesat e saj mund të kryejë çdo lloj operacioni industrial, tregtar, financiar, në pasuri të tundshme ose të pa tundshme, duke përfshirë edhe kërkesën për kredi e financime duke dhënë garancite e nevojshme në emër të shoqërisë. Shoqëria merr përsipër vetëm me qëllim të një investimi të qëndrueshëm pjesëmarrje të drejtëpërdrejt ose jo në shoqëri të tjera. Shoqëria do të zhvillojë aktivitete publiciteti, reklamash, marketing në të gjitha format dhe për të gjithë sektorët në të cilët do të vepronë dhe do të prodhojë. Shoqëria do të kryejë shërbime të ndryshme sponsorizimi. - Shoqëria do të kryejë shërbime asistencë pas shitje për produktet e shitura nga shoqëria dhe për të tjerë. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo lloj aktiviteti shtesë që rezultojnë i nevojshëm dhe i dobishëm për përmbushjen e qëllimit kryesor ku mund të përfshihen tregtimi i prodhimeve të tjera dhe kryerja e shërbimeve të tjera. Me qëllim që të realizojë objektin e vetë me vendim të organit të vetë vendimarrës shoqëria mund të zotërojë drejtëpërdrejt ose jo aksione ose pjesëmarrje në shoqëri të tjerashqiptarë ose jashtë Shqipërisë. Shoqëria me vendim të organit të saj vendimarrës me qëllim që të arrijë objektin e vetë mund të marrë pjesë në çdo lloj marrëveshje tregtare, në joint-venture(bashkëpunim) me shoqëri të tjera si dhe të kryejë çdo lloj veprimi tjetër të nevojshëm. Shoqëria mund të firmosë marrëveshje vendodhje ,shitje-blerje, marrëveshje për hipotekë, për pasuri të paluajtshme, marrëveshje për hua ose financime, marrëveshje për të ofruar shërbime si dhe çdo lloj marrëveshje tjetër që konsiderohet i nevojshëm për vazhdimësinë e realizimit të objektit të vetë. Në fushën e ndërtimit shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave publike dhe/ose private si: ndërtimin e ndërtësive publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe të gjitha veprave të tjera madhore, ujësjellesave, linjave mbitokesore dhe nëntokesore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujëtare, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike etj. Të ushtrojë aktivitetin në fushën e transportit të mallrave për vetë dhe për të tjerë. Dhenie me qera të automjeteve dhe makinerive në pronësi të Alu Glass shpk. Import - Eksport mallrash.

Neni 5 **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 ALL, i ndarë në 1 kuota me vlerë nominale 100 ALL për kuotë. Të gjithë Ortakët kanë nënshkruar dhe derdhur pjesën e tyre të kapitalit.

Ortakët zotërojnë kuotat e mëposhtme të kapitalit të Shoqërisë:

11- Ortak themelues Sokol Parllaku, zotëron një kuotë në vlerën 100 ALL e cila përbën 100 % të kuotave. Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Organet Vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme;
- 2- Administratori.

Shoqëria ka të drejtë që në të ardhmen të shtojë organet e saj, siç mund të jetë Këshilli Administrativ.

Neni 9

Asambleja e Përgjithshme

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme janë: z.Sokol Parllaku.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10 **Administrimi**

Administrator i shoqërisë është z **Z. Sokol Parllaku** shtetas shqiptar, i biri i Fatmir, lindur me 28/07/1991 në Kukës, banues në Tiranë, nr. personal J10728064P i emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo te huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shakllëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11 **Viti Financiar**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12 **Shpërndarja ose Prishja e Shoqërisë**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë, emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 13 **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14 **Dispozitat Përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm u miratua në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të **shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "SKY GLASS"**, dhe nënshkruhet nga të gjithë Ortakët themelues në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKËT
